



Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup

Dokumenti për politikë publike

Drejtesia në Republikën e Maqedonisë përmes prizmit të Strategjisë së EJL 2020 pikëpamjet e sektorit civil

Shkup, Dhjetor 2016

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Pikëpamjet e shprehura ktu në asnjë mënyrë nuk pasqyrojnë mendimin zyrtar të Këshillit për Bashkëpunimit Rajonal.

**Botues:**

Instituti për politik europiane (EPI) - Shkup

Redaktore:

Dr. Malinka Ristevska Jordanova

Autorë:

Dr. Malinka Ristevska Jordanova

Ardita Abazi Imeri

Dr. Ljubica Karamandi

Përkthimi:

Poliglot Plus

Përpunimi teknik:

Vladimir Gjorgjevski

Shtypjes:

Printline



CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје


347.962.3/.6(497.7)"2016"(047)

RISTEVSKA Jordanova, Malinka

Drejtësia në Republikën e Maqedonisë përmes prizmit të strategjisë së EJI 2020 : pikëpamjet e sektorit civil : Dokumenti për politikë publike / [autorë Malinka Ristevska Jordanova, Ardita Abazi Imeri, Ljubica Karamandi]. - Shkup : Instituti për politik europiane (EPI), 2017. - 20 стр. ; 21 см

ISBN 978-608-4702-25-2

1. Abazi Imeri, Ardita [автор] 2. Karamandi, Ljubica [автор]. - I. Jordanova, Malinka Ristevska види Ristevska Jordanova, Malinka a) Судство - Независност - Македонија - 2016 - Извештаи COBISS.MK-ID 102623242



Përmbajtje:

REZYME	4
HYRJE	5
Gjyqësori: Nuk ka cilësi pa pavarësi	6
Bashkëpunimi ndërkufitar shkakton vëmendje më të vogël	9
Mbështetja e zgjidhjes alternative të kontesteve	12
REKOMANDIME	16

REZYME

Në këtë dokument janë përmbledhur të dhënat e Projektit gjashtëmujor të monitorimit të zbatimit të Strategjisë së EJL 2020 “Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JuDGMeNT)” në periudhën kohore korrik - dhjetor 2016 në Republikën e Maqedonisë. Projekti e inicioi monitorimin strukturor të zbatimit të këtij aspekti të Strategjisë, përmes përfshirjes së organizatave qytetare dhe debatit të avancuar publik me faktorët relevantë.

Për secilën nga tri masat/instrumentet të parashikuara me Strategjinë në fushën e drejtësisë janë prezantuar të dhënat kyç dhe janë parashtruar opsione dhe rekomandime për tejkalimin e dobësive të konstatuara.

Sa i përket **masës së parë** të Strategjisë, të dhënat kryesore janë se objektivat e përcaktuara sipas natyrës së gjërave, janë të ndërlidhura në mënyrë inhereente me çështjet për pavarësinë e përgjithshme. Gjendjet vënë në dukje se depolitizimi i gjyqësorit, investimet financiare dhe kadrovike, si dhe cilësia e drejtësisë doemos duhet të jenë lartë në agjendën e prioriteteve shtetërore.

Analiza e gjendjeve të **masës së dytë** të Strategjisë vë në dukje mostransparencën e institucioneve dhe kompleksitetin e procedurave ndërkufitare sa u përket efekteve negative ndaj investitorëve dhe qytetarëve. Përmirësimi i klimës afariste dhe bashkëpunimi rajonal imponojnë aktivitete gjithëpërfshirëse ligjvënëse dhe organizative.

Gjendjet sa i përket masës së tretë e vënë në dukje moskonsekuencën në rregullimin ligjor të ZAK, mosgatishmërinë institucionale për zbatimin e plotë të akteve normative dhe pasivitetin e faktorëve relevantë. Edhe sa i përket kësaj mase nevojitet të ndërmerren një sërë hapash të rëndësishëm.

Përveç kësaj, janë prezantuar edhe rekomandime për monitorimin e prioriteteve të Strategjisë EJL 2020 në fushën e Drejtësisë nga ana e sektorit civil.

HYRJJE

Ky dokument i politikës publike ka për qëllim:

- t'i pasqyrojë të dhënat kryesore lidhur me gjendjet në Republikën e Maqedonisë sa u përket prioriteteve të Strategjisë së EJL 2020, me fokus mbi çështjet më aktuale, si dhe të ofroj rekomandime adekuatë për tejkalimin e të njëjtave;

- të ofrojë rekomandime për monitorimin strukturor të masave/instrumenteve të Strategjisë së EJL 2020 në fushën e drejtësisë, duke e pasur parasysh përvojën e Republikës së Maqedonisë.

Strategjia e EJL 2020: *Vende të punës dhe perspektiva evropiane* (në tekstin në vijim Strategjia), e miratuar në vitin 2013, synon përmirësimin e kushteve të jetës në rajon dhe kthimin e sërishëm në fokus të çështjeve në lidhje me konkurrencën dhe zhvillimin. Strategjia është fokusuar mbi pesë shtylla të zhvillimit të ndërlidhura mes tyre, në mesin e të cilave edhe **Qeverisja për rritje**. Kjo shtyllë bazohet në idenë për rritjen e kapacitetit të administratave publike në mënyrë që të përforcohet sundimi i së drejtës, si dhe të reduktohet korrupsioni, me qëllim të krijimit të klimës e cila e stimulon punën e bizneseve dhe i siguron shërbimet publike të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin ekonomik. Shtylla përmban tre dimensione – njëri prej tyre është dimensionin **Drejtësi**, në të cilin janë identifikuar tre prioritete.

Metodologjia për përgatitjen e këtij dokumenti për politikë publike, kryesisht bazohej mbi analizën juridike dhe komparative të kornizës ligjore për çështjet relevante dhe raportet e aksesshme të institucioneve kompetente. Gjendja fillestare në Republikën e Maqedonisë, për të tria masat/instrumentet u përcaktua në Raportin iniciues. U përcaktua metodologjia për monitorimin e strukturuar, e cila përfshin edhe indikatorë për secilin nga tre prioritetet. Për informacione të caktuara u zbatuan intervista me gjyqtarë dhe ndërmjetësues. Në përputhje me indikatorët, u paraqitën kërkesa për qasje të lirë deri te informacionet adresuar institucioneve relevante, megjithatë, u pranuan përgjigje për një pjesë të vogël të tyre. Njëkohësisht, u organizuan tre debate publike prej të cilave rezultuan rekomandime cilësore për monitorimin e mëtutjeshëm të zbatimit të Strategjisë së EJL 2020 në dimensionin *Drejtësi*.

Duhet të nënvizohet se Projekti u zhvillua në periudhën parazgjedhore. Kjo gjithsesi se pati ndikim mbi pjesëmarrjen e subjekteve politike – para së gjithash të partive politike dhe përfaqësuesve të pushteti ligjvënës dhe ekzekutiv, si faktorë të rëndësishëm në këtë fushë. Megjithatë, pjesëmarrja e të gjithë faktorëve të tjerë ishte e rëndësishme dhe konstruktive.

Në procesin eurointegruar të Republikës së Maqedonisë dokument kyç janë Prioritetet Urgjente të Reformave,¹ të cilat Komisioni Evropian i parashtroi në qershor të vitit 2015, pas Raportit të Grupit të Ekspertëve të Lartë për çështje sistemore të sundimit të së drejtës.² Gjyqësori e zë vendin qendror në këtë dokument.

Dokumenti i politikës publike veç e veç i shqyrton të tre prioritetet në dimensionin **Drejtësi**, ndërsa në fund janë dhënë rekomandime në dimensionin e cekur të Strategjisë së EJL 2020 edhe atë një pjesë e sistematizuar sipas rëndësisë rajonale dhe relevancës për Republikën e Maqedonisë, ndërsa një pjesë tjetër sipas prioriteteve të dimensionit **Drejtësi**.

Gjyqësori: Nuk ka cilësi pa pavarësi

Kjo masë e Strategjisë bindshëm e tërheqë vëmendjen më të madhe të organizatave joqeveritare në Republikën e Maqedonisë. Gjyqësorin, tanimë të strukturuar, e monitorojnë më shumë rrjete dhe organizata, me specializime gjithnjë e më të theksuara, si dhe me një bashkëpunim të rritur në pjesën e përfaqësimit. Megjithatë, i pamjaftueshëm është bashkëpunimi me shoqatat profesionale në fushën gjyqësorit.

Strategjia e EJL 2020 iu shmanget çështjeve të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit të cilat, nga ana tjetër, viteve të fundit ishin në plan të parë në mbarë rajonin.³ U tregua si e pamundur të monitorohen dhe analizohen aspektet e kompetencës, cilësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit pa u përkushtuar vëmendja e nevojshme mbi pavarësinë, paanshmërinë dhe përgjegjësinë. Rasti i Republikës së Maqedonisë, kthimi pas i të cilës, veçanërisht sa i përket pavarësisë së gjyqësorit, është evident dhe ilustrativ. Së këtejmi, vlerësojmë se sido që të jetë Strategjia, e cila ka të bëjë me jurisprudencën e rajonit, nuk guxon ta shmang pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.⁴

Republika e Maqedonisë ishte njëri nga vendet e para të rajonit që i filloi reformat në fushën e gjyqësorit, në kontekstin e proceseve eurointegruese, me miratimin e Strategjisë për reformë të sistemit të jurisprudencës 2004–2007 dhe me miratimin e amendamenteve kushtetuese. Më shumë se një dekadë pas kësaj, korniza juridike në Republikën e Maqedonisë i sanksionoi thuaja se të gjitha standardet e rëndësishme ndërkombëtare për gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm. Megjithatë, mungon harmonizimi në zbatimin e tyre dhe në praktikën e gjykatave.

Rezultatet e arritura pa mëdyshje gjatë dekadës së kaluar në fushën e efikasitetit janë zbehur nga politizimi i shtuar dhe pavarësia e cenuar, si dhe nga cilësia e ulët e gjyqësorit, e që të gjitha bashkë kontribuuan që Komisioni Evropian, dy vjet rresht, të konstatoj kthim pas në fushën e gjyqësorit.⁵

¹"Urgent Reform Priorities for the Former Yugoslav Republic of Macedonia (June 2015)." European Commission., June 2015. http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_urgent_reform_priorities.pdf.

²"Recommendations of the Senior Experts' Group on Systemic Rule of Law Issues Relating to the Communications Interception Revealed in Spring 2015." European Commission, June 8, 2015. http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf.

³European Commission, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, 2016 Communication on EU Enlargement Policy.

⁴EPI, Raport tematik i Projektit: "Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JuDGMeNT)" "PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT DHE KOMPETENCËS: PASQYRË E CILËSISË, EFIKASITETIT DHE KOMPETENCËS SË GJYQARËVE DHE GJYKATAVE", shih në: http://epi.org.mk/docs/lzveshtaj_kvalitet_kompetentnost_efikasnost.pdf Shkujt, dhjetor 2017, f. 16-18

⁵Raport i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë 2015, f. 63 dhe Raporti i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë 2016, f. 47

Ekzistojnë raporte të përsëritura në lidhje me drejtësinë selektive dhe ndërhyrjen politike në disa lëndë gjyqësore të profilit të lartë ose politikisht sensitive. Prokuroria Speciale Publike, e cila duhet t'i ndjek lëndët në lidhje me skandalin me përgjimin e paligjshëm masiv nga viti 2015, ballafaqohet me obstrukcione jo vetëm nga pushteti ekzekutiv por edhe nga vet gjyqësori. Zgjidhja gjyqësore e lëndëve që kanë të bëjnë me këtë skandal është një test për mundësinë që gjyqësori ta fitojë pavarësinë. Kohëve të fundit, gjendjet e këtilla shqetësuese e hapin debatin për rishikimin e mundshëm të mandateve të gjyqtarëve.⁶

Prioritetet Urgjente të Reformave në fushën e gjyqësorit nuk zbatohen ose zbatohen vetëm në mënyrë selektive.⁷ Edhe përkrah faktit që Këshilli Gjyqësor është formuar “nga gjyqtarët për gjyqtarët” me një përbërje që ia jep shumicën e votave kastës së gjyqtarëve, në praktikë është i fuqishëm ndikimi i degëve të tjera të pushtetit. Mostransparenca e Këshillit Gjyqësor dhe mungesa e pavarësisë ishin evidente edhe gjatë grevës së administratës gjyqësore kur bëheshin presione mbi nëpunësit gjyqësorë.⁸

Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve fokusin e vë mbi kriteret kuantitative në vend që ta vë mbi kompetencat themelore të gjyqtarëve. Nuk është parashikuar mundësia e ankimit ndaj vendimit të Këshillit Gjyqësor për zgjedhjen e gjyqtarit.

Gjithashtu, kushtet për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës nuk mundësojnë që në mënyrë adekuate të vlerësohen aftësitë menaxheriale të kandidatëve për kryetar të gjykatës.

Aktet normative lënë hapësirë që gjyqtari të sanksionohet në bazë të numrit të vendimeve të cilat janë modifikuar nga ana e gjykatës më të lartë. Ushtrimi joprofesional dhe i pandërgjegjshëm i funksionit si bazë për shkarkim mund të interpretohet gjerë e gjatë, meqë aktet normative nuk bëjnë një precizim më të saktë. Procedura e përcaktimit të përgjegjësisë së gjyqtarit panevojshëm është komplikuar dhe lë hapësirë për keqpërdorime.

U miratua vendimi për reduktimin e numrit të gjyqtarëve dhe njëkohësisht u rrit numri i nëpunësve gjyqësorë. Edhe krahas kësaj, Këshilli Gjyqësor vlerëson se ka mungesë të kuadrit udhëheqës, profesional dhe administrativ - teknik. Në mungesë të një strategjie gjithëpërfshirëse për administrim me resurset njerëzore në gjyqësor⁹ nuk mund ta dimë nëse kjo ka të bëjë vetëm me numrin e administratës gjyqësore apo edhe me mungesën e përgatitjes adekuate profesionale.

⁶Nga debati i mbajtur më datë 22 dhjetor 2016 në Shkup

⁷Statusi i realizimit të Prioriteteve Urgjente të Reformave, i aksesshëm në: <http://www.merc.org.mk/status-na-realizacija-na-itni-reformski-prioriteti>

⁸Statusi i realizimit të Prioriteteve Urgjente të Reformave, i aksesshëm në: <http://www.merc.org.mk/status-na-realizacija-na-itni-reformski-prioriteti>

⁹Në muajin nëntor të vitit 2015, Këshilli Gjyqësor miratoi vendim për reduktimin e numrit të gjyqtarëve nga 740 në 636. Edhe pse anëtarët e Këshillit Gjyqësor pohojnë se vendimi i këtillë është miratuar në bazë të analizës paraprake, publiku nuk është njoftuar me argumentet. Në fillim të vitit 2016 në pushtetin gjyqësor ka pasur thujta se 2500 nëpunës administrativë dhe gjyqësorë, e që është rritje prej 5% krahasuar me fundin e vitit 2014.

Mjetet buxhetore për gjykatat maqedonase për vitin 2016 në masë të konsiderueshme janë më të ulëta nga mesatarja evropiane për kokë banori, ndërsa numri i gjyqtarëve dhe personelit gjyqësor është në masë të konsiderueshme më i lartë nga mesatarja evropiane, e që rrjedhimisht parashtrohet pyetja për efikasitetin dhe shpërndarjen e drejtë të resurseve. Këshilli Gjyqësor Buxhetor në praktikë është i detyruar t'i pranojë kufizimet e imponuara financiare. Mosrespektimi i shumës së parashikuar ligjore prej 0,8% nga bruto prodhimi vendor për sistemin e jurisprudencës, në mënyrë të qartë e vë në dukje se ai akoma është në “kthetrat” e politikës.

Në vitin 2015 është vërejtur efikasiteti i gjykatave në Republikën e Maqedonisë. Megjithatë, në praktikë akoma ka probleme të cilat në mënyrë serioze e ulin cilësinë e drejtësisë.

Së këtejmi, sa i përket rrjedhës së procedurave gjyqësore, shkak më i shpeshtë për shtyrjen e tyre, është mungesa e njëres nga palët ose mospasja akses e organeve të ndjekjes, si dhe mospasja e kushteve që personat në paraburgim dhe personat e dënuar të shoqërohen deri në gjykatë, me ç'rast vihen në pikëpyetje parimet për një gjykim të ndershëm dhe të drejtë. E drejta e gjykimit në afat të arsyeshëm cenohet edhe nga gjykatat themelore edhe nga gjykatat e apelit, veçanërisht përmes shtyrjes së shpalljes së aktgjykimeve. Vazhdon praktika e miratimit të vendimeve të ndryshme për situata të njëjta juridike, ndërsa vendimet gjyqësore jo rrallëherë kanë arsyetime adekuate, edhe pse janë vërejtur përpjekjet e Gjykatës Supreme që të sigurohet konsistencë e aktgjykimeve. Më së shumti shqetësojnë vlerësimet për cilësinë e ulët të vendimeve gjyqësore, të cilat sqarohen me presionin e afateve dhe normave mbi gjyqtarët, por edhe me mungesën e kompetencave.¹¹

Qasja në internet në fushën e drejtësisë dhe praktikës gjyqësore në princip është e aksesshme, por në praktikë është e paqëndrueshme. Metodologjia statistikore gjyqësore, e cila u prezantua nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2011 akoma nuk është implementuar.

Shqetëson puna e Gjykatës Administrative, e cila nuk merr vendime meritore kundër aktvendimeve të organeve shtetërore dhe refuzon të miratojë vendime përfundimtare përmes të cilave do të mbrohen të drejtat e qytetarëve. Ligji i ri për procedurë penale nuk implementohet plotësisht. Ekzekutimi i vendimeve në fushën civile dhe administrative është kompleks dhe i kushtueshëm, ndërsa ekzekutimi i rasteve penale është “tolerant” për shkak të kushteve joadekuate nëpër burgje dhe mungesës së kapaciteteve të gjyqësorit që procedurat t'i zhvillojë plotësisht.

¹⁰Gjykatat Themelore dhe Gjykata Administrative kanë zgjidhur 2% më shumë lëndë nga prurjet. Për fat të keq, me një fakt të këtiillë nuk mund të lavdërohen gjykatat e apelit, si dhe Gjykata Supreme dhe Gjykata e Lartë Administrative. Sa i përket vitit 2016 pritet përkeqësim i treguesve për shkak të grevës së administratës gjyqësore, e cila zgjati 58 ditë

¹¹ EC Republic of Macedonia 2016 Report, p.14 dhe Konkluzionet nga Diskutimi i mbajtur më datë 22 dhjetor 2016 në Shkup

Janë bërë përpjekje për ekzekutimin e shpejtë të aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, megjithatë ka akoma aktgjykime të pa-ekzekutara.

Indikatorët e pranuar ndërkombëtarisht lidhur me perceptimin e publikut, përkatësisht segmente të caktuara të publikut, e vënë në dukje zvogëlimin e besimit ndaj gjyqësorit, përkatësisht mendimin e përkeqësuar në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit në Maqedoni.¹²

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, në mënyrë intensive punon brenda vendit, si dhe në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, për fat të keq, me ndihmën e madhe të donatorëve të huaj edhe krahas rritjeve buxhetore.¹³ Gjenerata e gjashtë e pjesëmarrësve të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë akoma nuk ka filluar me trajnime për shkak të procedurave disamujore ankimore të cilat zhvillohen para Gjykatave Administrative. Joefikasiteti institucional dhe prolongimi i gjeneratës së gjashtë çojnë në konkluzion se investimet në kuadro kualitativ në gjykata nuk është lartë në agjendën shtetërore.¹⁴ Numri i organizatave qytetare të cilat bashkëpunojnë me Akademinë filloi të reduktohet. Akademisë i nevojiten resurse më të mëdha financiare dhe kadrovike që t'u përgjigjet nevojave të mëdha – përfshirë këtu edhe ato që kanë të bëjnë me zhvillimin e të ashtuquajturave aftësi intelektuale, si dhe të nevojave për trajnime për të drejtën e BE dhe aplikimin e saj.¹⁵

Bashkëpunimi ndërkufitar shkakton vëmendje më të vogël

Nga tri masat – instrumentet e Strategjisë, kjo masë është më specifike, por edhe e atillë që deri më tani në Republikën e Maqedonisë ka shkakuar më së paku interesim edhe në publikun profesional edhe në atë më të gjerë. Për fat të keq, nuk ekzistojnë organizata qytetare të cilat në mënyrë strukturore e monitorojnë zbatimin e kësaj fushe.

Aspekte të caktuara të kësaj fushe monitorohen në mënyrë sekondare, josistematike, vetëm nëse mbivendosen interesat e ndonjëres nga organizatat qytetare ose politike me aktivitet të caktuar dhe konkret në lidhje me falimentimet ndërkombëtare, transferimet dhe bashkimet ndërkombëtare.¹⁶ Fitohet përshtypje se mbrojtja e interesave dhe të drejtave gjatë zbatimit të aktiviteteve afariste dhe investuese nuk realizohet në mënyrë përkatëse.¹⁷

¹² Raporti Global për Konkurrencë për vitet 2016–2017 të Forumit Ekonomik Botëror dhe Raporti për Indeks të Sundimit të së Drejtës të Projektit Drejtësia Botërore

¹³ Në vitin 2015 Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev” siguroi 267 trajnime të vazhdueshme për 5 888 pjesëmarrës. Nga gjithsej 13 kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë të gjeneratës së pestë e cila e përfundoi me sukses trajnimin fillestar në muajin shkurt të vitit 2016, 12 tanimë janë punësuar në gjykata themelore dhe prokuroritë themelore publike. Buxheti i Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë për vitin 2016 është rritur për 15% krahasuar me buxhetin e vitit 2015.

¹⁴ Nga debati i mbajtur më datë 22 dhjetor 2016 në Shkup

¹⁵ EPI, Raport tematik i Projektit: “Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JudgMENT) “PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT DHE KOMPETENCËS: PASQYRË E CILËSISË, EFIKASITETIT DHE KOMPETENCËS SË GJYQTARËVE DHE GJYKATAVE”, shih në: http://epi.org.mk/docs/lzveshtaj_Kvalitet_Kompetentnost_efikasnost.pdf Shkup, dhjetor 2017, f. 18

Republika e Maqedonisë është nënshkruese e konventave për ndihmë ndërkombëtare, ndërkohë që ka nënshkruar edhe marrëveshje bilaterale me më shumë vende (Shqipërinë, Bosnjë e Hercegovinën, Bullgarinë, Malin e Zi, Kroacinë, Kosovën, Rumaninë, Ukrainën, Slloveninë, Serbinë dhe Turqinë). Kërkesave, të parashtruara pranë Ministrisë së Drejtësisë për përgjigje sipas indikatorëve të përcaktuar, Ministria nuk dha të dhëna me përgjigjen se nuk ka në dispozicion informacion të tillë, kështu që, nuk mund të japim as vlerësim të përafërt për cilësinë e zbatimit të ndihmës juridike ndërkombëtare. Është nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim me Eurojust, megjithatë, sipas Raportit të Komisionit Evropian nga viti 2016, në praktikë ekziston bashkëpunimi i vogël.¹⁸

Sa i përket bashkëpunimit gjyqësor për qasje të lirë në informacione lidhur me ekzekutimet ndërkufitare dhe procedurat ndërkufitare për falimentim, transferim dhe bashkim, është karakteristike se bëhet fjalë për procedura të ndryshme të cilat gjykatat nuk i zbatojnë çdoherë. Ekzistojnë më shumë bartës të informacioneve dhe nuk ka mënyrë të strukturuar të monitorimit të tyre, ndërsa nga ana tjetër aksesit deri te të njëjtat është rreptësisht i kufizuar.

Për momentin, në Republikën e Maqedonisë nuk është lehtësisht e aksesshme informata zyrtare për zbatimin e ndonjë ekzekutimi ndërkufitar për faktin se ekzekutimin e aktgjykimeve gjyqësore të huaja e zbatojnë përmbarues si persona me autorizime publike. Së këtejmi, burim i vetëm i mundshëm i informacionit, në rast të ekzekutimit ndërkufitar në territorin e Republikës së Maqedonisë është Dhoma e Përmbaruesve e Republikës së Maqedonisë, e cila do të duhej t'i monitoroj rastet e këtilla, para së gjithash, nga aspekti i efikasitetit të ekzekutimit dhe publikimit transparent të informacioneve. Ky lloj i informacioneve, për fat të keq, nuk publikohet në ueb-faqen e Dhomës së Përmbaruesve.

Diç më ndryshe është situata me qasjen e lirë deri te informacionet për zbatimin e procedurës ndërkufitare të falimentimit, duke e pasur parasysh se procedurën e falimentimit e zbaton gjykata në vendin në të cilin gjendet prona dhe vendoset një lloj i caktuar i bashkëpunimit midis drejtorëve të falimentimit. Sipas rregullit, informatat për këto konteste duhet të publikohen në ueb-faqen e gjykatës kompetente dhe në buletinin përkatës të shtetit. Njëherësh, Regjistri Qendror, si bazë nacionale e të dhënave për personat juridikë, në ueb-faqen e vet rregullisht publikon të dhëna për procedurat e falimentimit dhe rrjedhën e tyre.

Të dhënat për bashkëpunimin gjyqësor të gjykatave maqedonase me gjykatat e

¹⁶Rast i këtillë është aktiviteti i partisë politike Levica lidhur me funksionimin e BEG, operatori i sistemit të ngrohjes termike në Republikën e Maqedonisë. Levica bën përpjekje që ta zbuloj strukturën pronësore të BEG, si faktor që, sipas tyre, në mënyrë plotësuese e rëndon keqpërdorimin e padrejtë të një numri të madh të konsumatorëve të BEG.

¹⁷EPI, Raport tematik i Projektit: "Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JuDGMent)" BASHKËPUNIMI GJYQËSOR LIDHUR ME QASJEN E LIRË DERI TE INFORMACIONET, ZBATIMIN E EKZEKUTIMIT NDËRKUFITAR DHE PROCEDURËS NDËRKUFITARE TË FALIMENTIMIT, TRANSFERIMIT DHE BASHKIMIT, shih në: http://epi.org.mk/docs/Monitoring%20izvestaj_prekugranicna%20osorobotka%20MK.pdf, Shkup, dhjetor 2017, f. 10

¹⁸EC Republic of Macedonia 2016 Report p.68

tjera të rajonit janë tejet të pakta. Ministria e Drejtësisë njofton se nuk ka në dispozicion të dhëna të këtilla, edhe pse një fakt i këtillë, me sa duket, është pak i besueshëm duke e pasur parasysh se përmes Ministrisë së Drejtësisë është rruga e rregullt për ndihmë juridike ndërkombëtare. Megjithatë, është për t'u përshëndetur projekti i paralajmëruar i Ministrisë së Drejtësisë, i cili nga mesi i vitit 2017 duhet të mundësojë akses deri te informacionet cilësore për ndihmë juridike ndërkombëtare.

Në lidhje me ekzekutimin e aktgjyqimeve të huaja në Republikën e Maqedonisë në kontestet civile dhe kontestet tregtare, fillimisht nevojitet që ato ta kalojnë fazën e njohjes sipas kushteve të parashikuara me Ligjin për të drejtën private ndërkombëtare ose në përputhje me marrëveshjet për ndihmë juridike me shtetet me të cilët i kanë lidhur. Pas përfundimit të kësaj procedure gjyqësore, ato mund të jenë objekt të ekzekutimit në përputhje me Ligjin për përbarim. Në praktikë ka më shumë probleme me të cilat ballafaqohen personat në rastet kur duhet të zbatojnë vendim të huaj në vend tjetër.¹⁹ Problem i veçantë gjatë ekzekutimit paraqet dërgesa e dokumenteve të qytetarëve maqedonas të cilët kanë vendqëndrim jashtë shtetit, me qëllim të afateve të shkurtra të cilët janë përcaktuar në Ligjin për përbarim. Veprimet ndërmerren përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë e që kanë efekt negativ mbi efikasitetin e zbatimit. Kur me marrëveshje ndërkombëtare parashikohet që bashkëpunimi të realizohet përmes gjykatave rezultatet janë shumë më të mira.²⁰

Zbatimi ndërkombëtar i falimentimeve, transferimeve dhe bashkimeve rregullohet me ligje përkatëse në Republikën e Maqedonisë të cilët formalisht, në masë të madhe, janë harmonizuar me legjislacionin evropian. Megjithatë, për atë se sa dhe si zbatohen zgjidhjet ligjore nuk ka analiza profesionale, kështu që informacionet për to bazohen mbi raste të caktuara të cilët janë aktualizuar në publik. Mungesa e monitorimit ekspert të zbatimit të ligjeve e përjashton mundësinë e detektimit efikas të dobësive dhe shmanjien e tyre.

Gjithashtu, është vërejtur se bashkëpunimi i deritanishëm bilateral dhe multilateral i shoqatave afariste, dhomave dhe trupave rregullatorë ndihmon në drejtim të shkëmbimit më të thjeshtë të informacioneve dhe realizimit më të lehtë të proceseve të bashkëngjijtes, bashkimit, transferimit, falimentimit dhe ekzekutimit.²¹ Shtetet e rajonit duhet t'i mbështesin përvojat e këtilla të mira dhe të stimulojnë bashkëpunim akoma më të madh.

¹⁹ Nga debati i mbajtur më datë 28 nëntor në Shkup

²⁰ Konkluzione nga debati i mbajtur më datë 28 nëntor 2016 në Shkup

²¹ EPI, Raport tematik i Projektit: "Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JuDGMeNT)" BASHKËPUNIMI GJYQËSOR LIDHUR ME QASJEN E LIRË DERI TE INFORMACIONET, ZBATIMIN E EKZEKUTIMIT NDËRKUFITAR DHE PROCEDURËS NDËRKUFITARE TË FALIMENTIMIT, TRANSFERIMIT DHE BASHKIMIT, shih në:

http://epi.org.mk/docs/Monitoring%20izvestaj_prekugranicna%20sorabotka%20_MK.pdf, Shkup, dhjetor 2017, f. 16-17

Mbështetja e zgjidhjes alternative të kontesteve – pa vendosmëri

Edhe pse ndërmjetësimi në Republikën e Maqedonisë është inkorporuar në vitin 2006, numri i lëndëve të zgjidhura me ndërmjetësim vazhdon të jetë i kufizuar.

Me Ligjin e ri për ndërmjetësim nga viti 2013 është inkorporuar licencimi i ndërmjetësuesve nga ana e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë, Këshillit për Sigurimin, Monitorimin dhe Vlerësimin e Cilësisë së Punëve të Ndërmjetësimit. Me këtë hap praktikisht u ndërpre puna e ndërmjetësuesve të cilët paraprakisht i kishin plotësuar kushtet e parapara me ligj (mbi 200 persona). Për fat të keq, për shkak të moszbatimit të kriterëve për zgjedhjen e ndërmjetësuesve dhe punës joprofesionale të Dhomës, reputacioni i profesionit të ndërmjetësuesit u rrezikua seriozisht. Megjithatë, shtrohet pyetja, a thua me mënyrën e tanishme të hyrjes në profesion do të sigurohet integriteti si dhe besimi para së gjithash nga ana e palëve dhe gjyqësorit.

Në periudhën e zbatimit të monitorimit, gjithsej 10 kandidatë e kaluan me sukses procedurën e licencimit, ndërsa 9 janë regjistruar në Listën e ndërmjetësuesve të licencuar, e cila është shpallur publikisht në internet faqen e Ministrisë së Drejtësisë. Në sesionin e nëntorit deri në pjesën e tretë të provimit (intervistës) procedurën e kanë kaluar 9 kandidatë.

Ndërmjetësuesit e licencuar janë persona me profile të ndryshme të profesioneve. Licenca ekzistuese është e vlefshme për pesë vjet. Provimi për ndërmjetësues është jashtëzakonisht kompleks, megjithatë joadekuat për këtë profil. Është i domosdoshëm intervenimi lidhur me mënyrën e vlerësimit të kandidatëve për ndërmjetësues, e cila do t'i merr parasysh edhe aftësitë specifike të domosdoshme për ushtrimin e ndërmjetësimit.²²

Impenjimet për jetësimin e ndërmjetësit janë bërë përmes inkorporimit të përpjekjes së detyrueshme për ndërmjetësim për kontestet ekonomike me vlerë deri në 1.000.000 denarë (rreth 16.000 euro). Në Regjistrin e evidencës për procedurat e ndërmjetësimit Më ministrinë e Drejtësisë janë regjistruar gjithsej 80 procedura të ndërmjetësimit (pas hyrjes në fuqi të Ligjit në vitin 2013). Janë arritur gjithsej 20 ujdë për ndërmjetësim, përfundimisht me datën 29 nëntor 2016. Gjendja e vë në dukje rritjen e numrit të ujdive të arritura.

Numri i lëndëve të ndërmjetësimit, në të cilat kanë vepruar ndërmjetësuesit e anketuar, në rastet ku është parashikuar përpjekja e detyrueshme e ndërmjetësimit, tanimë e tejkalon 100-shin. Padyshim, numri i lëndëve të paraqitura dhe të evidentuara në Regjistrin e evidencës së procedurave të ndërmjetësimit të cilin e udhëheq Ministria e Drejtësisë nuk korrespondon me numrin e lëndëve të regjistruara në regjistrat individual të ndërmjetësuesve. Dallimi në lëndët e evidentuara i referohet moskonsekuencës së Ligjit në

²²Nga debati i mbajtur më datë 2.12.2016

raport me obligimin e ndërmjetësuesve për paraqitjen e lëndëve deri te ministria kompetente dhe interpretimet e ndryshme. Është i domosdoshëm intervenimi ligjor për këtë çështje.

Janë ndërmarrë hapa të caktuara për promovimin e ndërmjetësuesve. Së këtejmi, gjykatat e kanë për detyrë ta publikojnë në tabelën e shpalljes së gjykatës listën e ndërmjetësuesve të licencuar dhe së këtejmi u kërkua nga kryetarët e gjykatave themelore të sigurojnë zyra për ndërmjetësim. Zyrat e këtilla tanimë janë në funksion të plotë në Gjykatën Themelore të Kavadarit, në Gjykatën Themelore të Vinicës dhe në Gjykatën Themelore Shkup 2 Shkup.

U shënua aktivizimi ndërkuftar i ndërmjetësuesve me pjesëmarrjen e tyre në Konferencën e parë ndërkombëtare të ndërmjetësuesve nga Evropa Juglindore që u mbajt në muajin tetor në Zagreb. Pjesëmarrësit nga vendet e ndryshme në këtë konferencë arritën dakordësim të ndërsjellë për formimin dhe regjistrimin e Shoqatës së Ndërmjetësuesve të Evropës Juglindore me seli në Zagreb, Republika e Kroacisë.

Sa u përket kompetencave të gjykatave themelore lidhur me praktikimin e ndërmjetësimit në kontestet civile dhe ekonomike, veprimi i gjyqtarëve është në kuadër të dispozitave të përcaktuara në Ligjin për procedurë kontestimore dhe në Ligjin për marrëdhënie detyrimore. Sistemi i monitorimit të lëndëve gjyqësore (sistemi AKMIS) akoma nuk është përsosur deri në atë masë që përmes tij të përmbliiden rezultatet nga veprimi i gjyqtarëve në lidhje me ndërmjetësimin.²³

Inkorporimi i obligimit për dërgesën e detyrueshme të njoftimeve me shkrim nga ana e gjykatës deri te palët për mundësinë e zgjidhjes së kontestit përmes ndërmjetësimit nuk i jep rezultatet e pritshme, ndërkaq bashkëpunimi institucional nuk është në nivelin e kënaqshëm, meqë mbështetja e një pjese të gjyqtarëve është vetëm deklarative. Edhe pse gjyqtarët të cilët veprojnë në shkallë të parë në mënyrë konsekuente i zbatojnë dispozitat e LPK dhe rregullisht paditësit dhe palës së paditur i dërgojnë njoftim me shkrim për ndërmjetësimin, megjithatë palët nuk janë të njoftuara për ndërmjetësimin si mundësi. Fitohet përshtypje se avokatët nuk i njoftojnë palët për mundësin e të drejtës së tyre që kontestin ta zgjidhin edhe në mënyrë alternative. Rrjedhimisht me këtë, është i nevojshëm lobimi më i madh për ndërmjetësimin në reformën e ardhshme të sistemit të jurisprudencës, dhe në këtë drejtim edhe stimulimin ndërmjetësimit duke i përfshirë këtu edhe ndryshimet ligjore në fushat në të cilat sipas analizave paraprakisht të bëra është konstatuar se ka hapësirë për inkorporimin e ndërmjetësimit.²⁴

²³EPI, Raport tematik i Projektit: "Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JuDGMeNT)" MBËSHËTETJA E ZAK: PËRMIRËSIMI I KORNIZËS LIGJORE PËR ZGJIDHJE ALTERNATIVE TË KONTESTEVE DHE MUNDËSIMIT TË BASHKËPUNIMIT JURIDIK DHE INSTITUCIONAL ME SISTEMIN GJYQËSOR DHE SISTEMIN E EKZEKUTIMIT, shih në: [http://epi.org.mk/docs/\(%D0%90%D0%A0%D0%A1\)%D0%BC%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%BD%D0%B3_%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98.pdf](http://epi.org.mk/docs/(%D0%90%D0%A0%D0%A1)%D0%BC%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%BD%D0%B3_%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98.pdf), Shkup, dhjetor 2017, f.7

²⁴Instituti për Politikë Evropiane, Zgjidhëni kontestin – po, me ndërmjetësim, Shkup, 2013 http://epi.org.mk/docs/resete_go_sporot_-_da_za_medijacija.pdf

Për fat të keq, Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë është pasive për organizimin e trajnimeve në temën ZAK, veçanërisht sa i përket ndërmjetësimit dhe arbitrazhit.

Ministria e Drejtësisë është faktor institucional e cila duhet të vendos bazë reale për qasje adekuate ndaj ndërmjetësimit dhe promovimit të tij. Për fat të keq, ZAK nuk specifikohet si prioritet politik, ndërsa resurset njerëzore janë të kufizuara. Këshilli për Sigurimin, Monitorimin dhe Vlerësimin e Cilësisë së Punës së Ndërmjetësimit, i cili përbëhet nga anëtarë të emëruar nga Qeveria e RM-së filloi me punë në muajin shtator të vitit 2014. Ky Këshill është organi kompetent ndërinstitucional, qëllimi kryesor i të cilit është implementimi i Ligjit për ndërmjetësim. Për fat të keq, nga dita e parë e konstituimit, Këshilli ballafaqohet me parregullsinë e anëtarëve dhe në këtë aspekt paraqiten një sërë probleme në zbatimin e Ligjit.²⁵ Në këtë drejtim nevojitet ridefinimi urgjent i Këshillit, përkatësisht zëvendësimi i anëtarëve që mungojnë me anëtarë të rinj që të mundësohet formimi i shumicës, kuorumit për punë dhe krijimi i kushteve për punë.

Për funksionimin papengesa dhe zhvillimin e ndërmjetësimit në Republikën e Maqedonisë dhe të ndërmjetësuesve të cilët tanimë e kanë fituar licencën për ndërmjetësues, urgjentisht nevojitet të formohet Dhomë e re e Ndërmjetësuesve në përputhje me Ligjin. Funksionimi i Dhomës ekzistuese është pengesa kryesore për zhvillimin e ndërmjetësimit.²⁶

Pajtimi dhe arbitrazhi në kontestet e punës në Republikën e Maqedonisë është rregulluar me Ligjin për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës i cili e inkorporoimundësinë që kontestet e punës të zgjidhen me ndërmjetësim.

mundësinë që kontestet e punës të zgjidhen me ndërmjetësim.

Në Republikën e Maqedonisë deri më tani janë trajnuar gjithsej mbi 90 persona, megjithatë dokumente licencimi dhe licenca të fituara kanë vetëm 41 pajtues dhe arbitra për konteste pune. Theksohet nevoja për harmonizimin më të madh midis ligjeve relevante. Është promovuar platforma virtuale “ESAP” e cila duhet të shërbejë si bazë e të dhënave nga rajoni në lidhje me kontestet e punës të zgjidhura me sukses. Informacionet kryesore për zgjidhjen e marrëdhënies kontestuese të punës, përmes pajtimit ose arbitrazhit, janë të aksesshme edhe në ueb-faqen e Asociacionit të Pajtuesve dhe Arbitrave për Konteste Pune në Republikën e Maqedonisë (www.apars.mk).

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë dy trupa të përhershëm të zgjedhur gjykues – Arbitrazhi pranë Dhomës edhe atë: Trupi i Përhershëm i Zgjedhur Gjykues – Arbitrazhi pranë Dhomës Ekonomike të Maqedonisë i cili është formuar në vitin 1993 dhe Trupi i Përhershëm i Zgjedhur Gjykues – Arbitrazhi pranë Lidhjes së Dhomave Ekonomike të Republikës së Maqedonisë i themeluar në vitin 2015. Të dyja Dhomat ekonomike i kanë

²⁵Nga debati i mbajtur më datë 2.12.2016

publikuar informacionet themelore për Trupin e Përherëshëm të Zgjedhur Gjykses – Arbitrazhin pranë Dhomës në ueb faqet e tyre të internetit. Vendimet e arbitrazhit janë përfundimtare dhe e kanë fuqinë e aktgjykimeve të plotfuqishme.

Janë emëruar 27 arbitra në kontestet pa element ndërkombëtar dhe 59 për konteste me element ndërkombëtar të cilat zhvillohen para Trupit të Përherëshëm të Zgjedhur Gjykses – Arbitrazhit pranë Dhomës Ekonomike të Maqedonisë.

Të dy arbitrazhet kanë marrëveshje të lidhura bashkëpunimi me arbitrazhe të tjera nga rajoni dhe më gjerë. Në periudhën e hulumtimit që ishte objekt i këtij raporti, nuk është vërejtur aktivitetet për promovimin e arbitrazhit në organizim të të dyja dhomave.²⁷

Nga ana tjetër, një numër i caktuar i organizatave joqeveritare në Republikën e Maqedonisë rregullisht ose periodikisht i përkushtojnë vëmendje zgjidhjes alternative të kontesteve, Është pozitiv fakti që me vetiniciativë ndërmjetësuesit, përmes bashkimit të tyre vullnetar, janë të hapur për bashkëpunim me organizata të tjera të sektorit joqeveritar.

²⁶EPI, Raport tematik i Projektit: "Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JuDGMeNT)" MBËSHTETJA E ZAK: PËRMIRËSIMI I KORNIZËS LIGJORE PËR ZGJIDHJE ALTERNATIVE TË KONTESTEVE DHE MUNDËSIMIT TË BASHKËPUNIMIT JURIDIK DHE INSTITUCIONAL ME SISTEMIN GJYQËSOR DHE SISTEMIN E EKZEKUTIMIT, shih në: [http://epi.org.mk/docs/\(%D0%90%D0%A0%D0%A1\)%D0%BC%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%BD%D0%B3_%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98.pdf](http://epi.org.mk/docs/(%D0%90%D0%A0%D0%A1)%D0%BC%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%BD%D0%B3_%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98.pdf), Shkup, dhjetor 2017, f. 11-12

²⁷EPI, Raport tematik i Projektit: "Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JuDGMeNT)" MBËSHTETJA E ZAK: PËRMIRËSIMI I KORNIZËS LIGJORE PËR ZGJIDHJE ALTERNATIVE TË KONTESTEVE DHE MUNDËSIMIT TË BASHKËPUNIMIT JURIDIK DHE INSTITUCIONAL ME SISTEMIN GJYQËSOR DHE SISTEMIN E EKZEKUTIMIT, shih në: [http://epi.org.mk/docs/\(%D0%90%D0%A0%D0%A1\)%D0%BC%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%BD%D0%B3_%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98.pdf](http://epi.org.mk/docs/(%D0%90%D0%A0%D0%A1)%D0%BC%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%BD%D0%B3_%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98.pdf), Shkup, dhjetor 2017, f. 14-15

REKOMANDIME

Sa i përket Strategjisë së EJL dhe monitorimit rajonal të dimensionit Drejtësi nga shtylla “Qeverisje për rritje” nga ana e sektorit joqeveritar propozohen rekomandimet si vijojnë:

1. Të sensibilizohet publiku në lidhje me rëndësinë e temave të përfshira në Strategjinë e EJL 2020, si dhe të stimulohen shoqatat qytetare, ndërsa në radhë të parë asociacionet afariste ta monitorojnë bashkëpunimin e organeve të jurisprudence,

2. Të stimulohet bashkëpunimi rajonal i sektorit joqeveritar për monitorimin strukturor të masave dhe prioritetëve të EJL dhe për përfaqësimin e përbashkët;

3. Të stimulohet bashkëpunimi rajonal i shoqatave profesionale në fushën e gjyqësorit, si dhe bashkëpunimi i tyre me organizata të tjera joqeveritare;

4. Në përcaktimin e mëtutjeshëm rajonal të prioritetëve në fushën e gjyqësorit fokusi të vihet mbi pavarësinë, paanshmërinë dhe përgjegjësinë e gjyqësorit;

5. Të stimulohet bashkëpunimi ndërkufitar midis dhomave (dhomave ekonomike, përmbauesve, falimentimit, ndërmjetësuesve, avokatëve etj.);

6. Të krijohet Rrjeti për Ndërmjetësim në nivel rajonal, si dhe baza e të dhënave të modeleve reprezentative, me qëllim të transponimit më të lehtë të know – how;

Për Republikën e Maqedonisë

1. Të merren parasysh prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e EJL 2020 në strategjinë e paralajmëruar për reforma në sistemin e jurisprudence në Republikën e Maqedonisë dhe në mënyrë përkatëse të identifikohen çështjet të cilat duhet të trajtohen;

2. Ndryshimet e akteve normative në fushën e gjyqësorit të bëhen sipas analizave paraprake, dialogut dhe konsultave të gjera me të gjitha palët e interesuara, duke mos e vënë në pikëpyetje sigurinë juridike;

Cilësia dhe efikasiteti i gjyqësorit:

1. Të rritet bashkëpunimi i sektorit joqeveritar me organizatat profesionale në fushën e gjyqësorit, me qëllim të presionit permanent për ndarjen e gjykatave nga ndikimi i pushtetit ekzekutiv dhe partive politike, ngritjen në nivel më të lartë të pavarësisë dhe paanshmërisë së funksionit të gjyqtarit dhe integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

2. Të përmirësohet sistemi i vlerësimit të punës së gjyqtarëve, në mënyrë që të sigurohet balanc adekuat midis aspekteve kualitative dhe kuantitative të punës.

3. Të rishikohen kushtet e zgjedhjes së kryetarit të gjykatës dhe të inkorporohen kritere ligjore që kanë të bëjnë me aftësitë e mira menaxheriale, si dhe me integritetin dhe autoritetin.

4. Të inkorporohet e drejta e ankesës në rastet e zgjedhjes së gjyqtarëve dhe zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqësorit.

5. Të respektohet minimumi i përcaktuar ligjor për buxhetin gjyqësor me rishikimin e bazave buxhetore, me qëllim të përcaktimit dhe shpërndarjes së drejtë të mjeteve;

6. Të krijohen kushte për shoqërimin e personave në paraburgim dhe personave të dënuar, me qëllim të respektimit të procedurave gjyqësore dhe respektimit të afateve;

7. Të bëhet vlerësimi i aspektit optimal të rrjetit ekzistues gjyqësor, si bazë për zbatimin e reformave të mëtutjeshme, së këtejmi duke u siguruar qytetarëve qasje në drejtësi;

8. Të avancohet statistika gjyqësore përmes përfshirjes së indikatorëve të parashikuar në EU Justice Scoreboard dhe qasje deri te i njëjti; sistemi ACCMIS i gjykatave t'i përpunojë më mirë të dhënat dhe rregullisht të publikohen të dhëna të azhuruara statistikore, në përputhje me Metodologjinë e statistikës gjyqësore;

9. Gjyqtarëve t'u sigurohet qasje e lehtë deri në kornizën ligjore, marrëveshjet ndërkombëtare, praktikën gjyqësore dhe ngjashëm. Të instalohet sistem adekuat për trajnim dhe për përsosje profesionale të nëpunësve administrativë dhe gjyqësorë.

10. Të instalohet sistem i përhershëm për monitorimin dhe evaluimin e trajnimeve të mbajtura nga ana e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, me qëllim që në mënyrë sistematike të monitorohet dhe avancohet suksesi dhe rezultatet e tyre.

11. Në programet e trajnimit të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë t'i përkushtohet vëmendje zhvillimit të të ashtuquajturave aftësi intelektuale të gjyqtarëve dhe aftësive të komunikimit.

Bashkëpunimi ndërkufitar gjyqësor, bashkëpunimi ndërkufitar lidhur me falimentimet, ekzekutimet, bashkimet dhe transferimet

1. Të intensifikohet lidhja e marrëveshjeve për ndihmë juridike ndërkombëtare midis shteteve, si dhe lidhja e protokolleve për bashkëpunim ndërkufitar midis institucioneve të instancave të njëjta;

2. Të revidohen procedurat që kanë të bëjnë me realizimin e ndihmës juridike ndërkombëtare dhe të miratohen ndryshime adekuate ligjore dhe njëkohësisht të shqyrtohet mundësia që gjuha angleze të përdoret në ndihmën juridike ndërkombëtare;

3. Të realizohen trajnime të rregullta të përfaqësuesve diplomatik për një sërë çështje që kanë të bëjnë me ndihmën juridike ndërkombëtare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, si për shembull, dërgesa e shkresave/dokumenteve, ndërsa në këtë drejtim të parashikohen protokolle në të cilët në mënyrë të saktë do të trajtohen veprimet e procedimit të institucioneve kompetente;

4. Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë të ndërmerr më shumë aktivitee në lidhje me bashkëpunimin ndërkufitar të organeve të jurisprudencës për çështje civile dhe penale,

5. Ministria e Drejtësisë dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme të krijojnë bazë të të dhënave për rastet e ndihmës juridike ndërkombëtare.

6. Të vendosen kontakte institucionale me institucionet kompetente të BE të cilat i mbajnë regjistrat për insolvencë, bashkim dhe transferim, me qëllim të shkëmbimit të informacioneve;

7. Nga ana e faktorëve kompetentë të mundësohet akses deri te informacionet në lidhje me ekzekutimin, falimentimin, bashkëngjitjen, bashkimin dhe transferimin.

Zgjidhja alternative e kontesteve

1. Qeveria e Republikës së Maqedonisë, ta promovojë më fuqishëm ndërmjetësimin dhe format e tjera të ZAK;

2. Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë sa më shpejtë të miratojnë programe për mbështetjen e ndërmjetësimin dhe t'i zbatojnë në mënyrë efektive;

3. Të ndryshohet korniza ligjore për shkak të inkorporimit të mundësisë së ndërmjetësimin në fusha të tjera të drejtësisë, inkorporimit të dërgesës elektronike gjatë ndërmjetësimin, harmonizimit të mbajtjes së regjistrave për procedurat e ndërmjetësimin të cilët i udhëheq Ministria e Drejtësisë dhe ndërmjetësuesit, si dhe revizioni i provimit të ndërmjetësuesve në mënyrë që të merren parasysh kompetencat dhe aftësitë e nevojshme të cilat duhet t'i posedojnë;

4. Të themelohet Dhoma e re e Ndërmjetësuesve;

5. Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë të organizojë trajnime që do t'i përkushtohen ndërmjetësimin dhe arbitrazhit;

6. Dhomat ekonomike dhe zyrat e tyre rajonale në Republikën e Maqedonisë ta stimulojnë bashkëpunimin me ndërmjetësuesit e licencuar, përmes mundësimin të përdorimit të hapësirës adekuate dhe mbështetjes tjetër;

7. Të inkorporohet mundësia që personat juridikë në pronësi shtetërore ta përfshijnë ndërmjetësimin gjatë zgjidhjes së kontesteve të tyre; para se të iniciohet procedura gjyqësore;

8. Të vendoset bashkëpunimi midis Asociacionit të Pajtuesve dhe Arbitrave me të gjitha sindikatat, si dhe me Organizatën e Punëdhënësve në Republikën e Maqedonisë;

9. Të shqyrtohen mundësitë e formave të kombinuara hibride të ndërmjetësimin – arbitrazhit, me qëllim që palëve t'u mundësohet përdorimi i kombinuar i të dyja procedurave në interes të zgjidhjes efikase, ekonomike dhe të shpejtë të kontestit në fjalë.

